VENDIM
Nr. 181, datë 6.11.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "GSA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 6.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 118/1 prot., datë 2.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "GSA" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "GSA" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 321, seria T11/15, të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike që prej datës 22.6.2011, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, me afat vlefshmërie deri në datën 22.6.2016, e cila më tej është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 28.12.2015, për pesë vjet të tjera deri në datën 22.6.2021.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 30.6.1993 është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform legjislacionit të kohës dhe mban NUIS-in përkatës.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", theksohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet: (Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës).

Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria "GSA" sh.p.k. ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë "GSA" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 2

- germa "c" (Vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB). Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Shoqëria ka përcjellë ekstraktin historik të saj, të datës 7.10.2020, i cili përmban vulë elektronike të QKB-së. Do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së.

Neni 9, pika 4.8

- germat: "a", "d" (sasia e energjisë elektrike, e parashikuar për t'u tregtuar në GWh/sipas viteve).

- Shoqëria ka bërë me dije sasinë që parashikon të tregtojë për tri vite. Do t'i kërkohet shoqërisë të sjellë sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë edhe për dy vitet e tjera të veprimtarisë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 306, seria FK15, të shoqërisë "GSA" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 23.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit ahmeti